



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor
Drejtoria për Buxhet dhe Financa



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVCEIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

=III- Nr. i prot. 3090 Më 21.08.2020
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC



VLERËSIMI EKONOMIK I NDIKIMIT TË PANDEMISË COVID-19 NË EKONOMINË E KOMUNËS SË RAHOVCEIT



Korrik 2020

Përmbajtja

1. Hyrje.....	4
2. Qëllimet dhe objektivat e projektit hulumtues	4
3. Përvetësimi i gjendjes.....	5
4. Metodologjia e hulumtimit.....	6
4.1. Intervistat cilësore	6
4.2. Anketa me biznese dhe ekonomi familjare	7
4.3. Modeli ekonomik	8
5. Rezultatet e studimit	122
5.1. Rezultatet e anketës me biznese	133
5.2. Rezultatet e modelit ekonomik.....	199
6. Përfundime dhe rekomandime.....	255

Listë e figurave

Figure 1. Mbyllja e bizneseve si rezultat i klimës së krijuar nga Coronavirusi	13
Figure 2. Vështirësitetë në pagesën e kësteve të kredisë.....	14
Figure 3. Anulimi i investimeve të planifikuara në infrastrukturë dhe/ose prodhim për shkak të shpërthimit të COVID-19?	15
Figure 4. Vlerësimi i ndikimit negativ ekonomik të Coronavirusit në biznese.....	16
Figure 5. Informimi i bizneseve lidhur me masat e ndryshme të mbështetjes nga Qeveria	17
Figure 6. Lloji i përkrahjes për t'iu ndihmuar bizneseve për të përballuar Coronavirus-in	17
Figure 7. Ndikimi negativ i Pandemisë Covid-19.....	18
Figure 8. Optimizmi i ndërmarrësve për të ardhmen pas pandemisë	19
Figure 9. Struktura e humbjeve në totalin e humbjeve ekonomike Gabim! Shenja e referimit e pa definuar.	

Listë e tabelave

Table 1. Vlerësimi i humbjeve në komunën e Rahovecit nga Covid-19, skenari bazë.....	19
Table 2. Vlerësimi i humbjeve në komunën e Rahovecit nga Covid-19, sipas veprimtarive kryesore, skenari bazë	23
Table 3. Vlerësimi i humbjeve në komunën e Rahovecit nga Covid-19, skenaret e ndryshëm, stres teste	24
Table 4. Vlerësimi i humbjeve në komunën e Rahovecit nga Covid-19, skenaret e ndryshëm, nëse situata do të vazhdoj me këto tendre (mungesa e mërgatës në Kosovë – 31 gusht dhe vazhdimi i pandemisë dhe masave kufizuese deri më 31 dhjetor 2020	
21	

1. Hyrje

Ky rapport i titulluar *Vlerësimi ekonomik i ndikimit të pandemisë COVID-19 në ekonominë e komunës së Rahovecit* është realizuar nga Konzorciumi i Institutit për Ndërmarrësi dhe Biznes të Vogël (IESB) dhe Integra Consulting Sh.P.K. me kërkesë të Komunës së Rahovecit, për të bërë vlerësimin e ndikimit të pandemisë në biznese dhe ekonomi familjare. Ky projekt është i përbërë nga një varg komponentësh të cilat për qëllim kanë hartimin e raportit për Vlerësimin ekonomik nga pandemia COVID-19 në ekonominë e komunës së Rahovecit.

Në pikën 2 – është përshkruar gjendja e krijuar si rezultat i pandemisë COVID-19, pastaj është prezantuar qëllimi i hulumtimit, metodologjia e hulumtimit, mostra e anketimit, rezultatet e hulumtimit dhe konkluzionet e rekomandimet.

2. Qëllimet dhe objektivat e projektit hulumtues

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është mbledhja dhe përpunimi i të dhënave ekonomike me qëllim të vlerësimit të dëmit ekonomik të shkaktuar nga pandemia COVID-19 në komunën e Rahovecit dhe nxjerra e rekomandimeve për masat sajuese për rimëkëmbjen e ekonomisë pas pandemisë. Këto informata do të shërbejnë për të përcaktuar hapat e ardhshëm të Komunës për të adresuar problemet dhe sfidat e bizneseve si dhe ekonomive familjare. Dokumenti i njëjtë do të shërbejë edhe për avokimin e Komunës te donatorët. Për më tepër, objektivat specifike të studimit janë:

- Vlerësimi ekonomik dhe financiar i dëmit të shkaktuar nga Covid-19 në ekonominë e komunës së Rahovecit;
- Organizimin e hulumtimit me një mostër reprezentative bazuar në numrin e përgjithshëm të bizneseve në komunën e Rahovecit (mostra sipas listës së bizneseve në ARBK - gjendja e bizneseve aktive në muajin janar të vitit 2020);
- Anketimi duhet të realizohet nëpërmjet kanaleve të komunikimit online për shkak të pandemisë. Te bizneset më të mëdha anketimi do bëhet në takime direkte për të vlerësuar me në detaje situatën. Ndërsa tek ekonomitë familjare anketimi do të bëhet direkt në familje, duke u bazuar në një mostër të përfaqësimit të seilit nënsektorë të bujqësisë e cila mostër është përzgjedhur me ndihmën e Drejtorisë së Bujqësisë në Rahovec;
- Përpilimi i pyetësorit dhe kodimi i tij në Excel dhe SPSS; dhe krijimi i një databaze në Excel dhe programe tjera statistikore SPSS që do të jetë pronë e Komunës së Rahovecit;
- Përpilimi i një raporti hulumtues ku do të paraqiten problemet kyçë me të cilat ballafaqohen ndërmarrësit në komunën e Rahovecit gjatë kohës së pandemisë dhe

masat e nevojshme të propozuara për përkrahjen e bizneseve për ta tejkaluar këtë situatë;

- Hartimi i një raporti përbledhës duhet t’iu drejtohet nevojave të Komunës së Rahovecit për të shqyrtuar mundësitë e përkrahjes dhe rimëkëmbjes së ekonomisë e cila është ndikuar negativisht nga pandemia COVID-19, dhe

3. Përshkrimi i gjendjes

Pandemia COVID-19 e cila u shfaq në fund të vitit 2019 së pari në Kinë dhe pastaj u shpërndua në tërë globin arriu edhe në Kosovë në mars 2020. Si rrjetohjë dhe për shkak të shpëndarjes së saj të shpejtë Qeveria e Republikës së Kosovës, në përputhje me rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik në Kosovë (IKSHPK), dhe ngjashëm me shumicën e vendeve tjera të botës, duke filluar nga data 13 mars 2020 ka vendosur masa me të cilat u ndaluan shumë veprimitari ekonomike dhe më pastaj edhe ndalim qarkullimin e njerëzve. Ndërsa masa tjera, u mbyllën të gjitha bizneset hoteliere dhe të gastronomisë, transporti ndërsa urban dhe bizneset tjera të cilat shesin mallra të specializuara (tekstil etj).

Pjesa më e madhe e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) tanimë janë prekur nga koronavirusi në shumicën e vendeve të botës. Kufizimet në lëvizje dhe distancimi social për të ngadalësuar përhapjen e sëmundjes do të thotë që furnizimi me fuqi punëtore, transporti dhe udhëtimi janë prekur drejtpërdrejtë në mënyra që nuk ishin gjatë krisës financiare. Sektorët e tërë të ekonomive kombëtare janë mbyllur, përfshirë hotelet, restorantet, tregtinë me pakicë jo-thelbësore, turizmin dhe pjesët e konsiderueshme të prodhimit. Në këto rrethana parashikimi për masa ekonomike dhe me pako mbështetëse për biznese kërkon supozime të forta në lidhje me përparimin e sëmundjes dhe një mbështetje më të madhe në të dhëna të vlerësuara sesa të raportuara.

Komuna e Rahovecit deri më tani ka qenë e prekur me rreth 100 raste të konfirmuara me Covid19, dhe numri i personave të infektuar po shtohet. Megjithatë, pasi që masat e Qeverisë së Kosovës ishin për tërë territorin e vendit, pa dalluar komunat më pak të prekura, pasojat ekonomike të mbylljes janë evidente dhe kërkojnë trajtim. Ekonomia në komunën e Rahovecit gjithashtu ka një sezonalitet të lartë dhe varet nga ardhja e diasporës së saj gjatë stinës së verës, e që nuk dallon shumë nga komunat tjera. Deri më tani vërehet një ardhje shumë më e vogël e diasporës se sa zakonisht. Në rast të mos ardhjes së tyre këtë verë, për shkak të virusit corona dhe vështirësive në qarkullim ndërkombëtar, atëherë pasojat ekonomike do të janë shumëfish më të larta sesa ato të deritanishme.

Bizneset në komunën e Rahovecit sikurse edhe në tërë Kosovën janë duke pasur pasoja të mëdha nga ndikimi i COVID-19. Përpos bizneseve formale, edhe ekonomitë familjare të cilat merren me bujqësi dhe tregtijnë në mënyrë joformale janë ndikuar shumë. Numri i të

punësuarve ka rënë dukshëm gjatë zbatimit të masave të mbylljes për shkak të ndaljes së aktivitetit ekonomik dhe kjo ka krijuar situatë të vështirë ekonomike dhe sociale. Prandaj, Komuna e Rahovecit do të realizojë një hulumtim në teren dhe një analizë ekonomike lidhur me matjen e ndikimeve të pandemisë në ekonomi dhe biznese brenda territorit të komunës, duke përfshirë periudhën nga 13 marsi deri në fund të muajit qershor. Mbledhja dhe analiza e këtyre të dhënave është e rëndësishme për të identifikuar pengesat dhe mundësitë e përkrahjes së bizneseve pas përfundimit të pandemisë dhe ringjalljen ekonomike të komunës.

4. Metodologja e hulumtimit

Metodologja e përdorur në një analizë ekonomike shkencore varet nga shumë faktorë relevantë siç janë: koha dhe resurset materiale dhe njerëzore në dispozicion, karakteristikat e fenomenit të analizuar, qëllimi i projektit, e shumë faktorë tjerë. Prandaj në këtë analizë të vlerësimit ekonomik të dëmit të shkaktuar në ekonominë e komunës së Rahovecit nga pandemia Covid-19 dhe masave të ndërmarrë në luftimin dhe parandalimin e shpërndarjes së mëtutjeshme të pandemisë, janë përdorur disa metodologji të ndryshme të kombinuara.

Për shkak të pamundësisë për të bërë një evidentim të plotë dhe një analizë të bazuar në të dhënat individuale të secilit biznes në komunën e Rahovecit, pasi që koha e shkurtër dhe resurset e pamjaftueshme nuk e kanë mundësuar një punë të tillë, kjo analizë është më e thjeshtësuar por gjithsesi gjithëpërfshirëse, dhe bazohet në metodat e listuara më poshtë: intervistat cilësore, anketa me biznese dhe ekonomi familjare (perim-kulture si prodhimi në serra ashtu edhe në fushë të hapur, blegtori, shpeztari, lavërtari dhe nënsektorët tjerë me rendësi në komunën e Rahovecit), si dhe modeli i posaçëm ekonomik.

4.1. Intervistat cilësore

Intervistat cilësore janë realizuar me zyrtarë komunal, përfaqësues të bizneseve dhe ekonomive familjare si dhe me disa nga bizneset me të mëdha e me ndikim në komunë. Këto intervista kanë mundësuar kuptimin më të mirë të kontekstit të problemit në komunën e Rahovecit dhe për të dizajnuar dhe kornizuar studimin sasior i cili është i bazuar në anketë me biznese dhe ekonomi familjare.

4.2. Anketa me biznese dhe ekonomi familjare

Anketa me biznese dhe ekonomi familjare është realizuar përmes anketimit online dhe metodës së anketimit direkt te biznesi. Anketat online me bizneset e komunës së Rahovecit, dërguar gjitha bizneseve ekzistuese dhe duke u bazuar në përgjigjen e tyre vullnetare. Anketimi i drejtpërdrejtë i një mostre reprezentative të bizneseve të cilat janë vizituar fizikisht nga anketuesit e angazhuar nga kompania anketimi dhe intervistimi i veçantë i kompanive më të mëdha dhe me peshë më të rëndësishme në ekonominë e komunës.

Në bashkëpunim me Komunën e Rahovecit, Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik kemi bërë listën e bizneseve aktive (sipas ARBK 3.223 biznese aktive), pastaj të dhënat i kemi aranzhuar me numrin e bizneseve që janë në listën e taksave komunale e që janë 1.982 biznese; si dhe me numrin e bizneseve që janë aktive në ATK (rrëth 1.723 biznese aktive) për komunën e Rahovecit, duke e marre parasysh edhe ekonominë joformale prej rrëth 30% (bazuar në të dhënat e shumë institucioneve si BB, FMN dhe raporteve të ndryshme kredibile për ekonominë joformale). Dizajnimi i metodologjisë ka qenë hapi tjetër i detajuar për zhvillimin e aktiviteteve të hulumtimit. Mostra prej mbi 104 ndërmarrjeve apo diku mbi 5% e bizneseve aktive, që mbulojnë veprimitari të ndryshme ekonomike konsiderohet reprezentative dhe rrjedhimisht ofron informacione kredibile për të përcaktuar qartë dëmin dhe nevojat e bizneseve. Gjithashtu edhe për ekonomitë familjare të komunës së Rahovecit (sipas Drejtorisë së Bujqësisë në komunën e Rahovecit janë të regjistruala me NIF diku rrëthe 3000 ekonomi familjare-v. 2020), prej këtyre të dhënavë është bërë një mostër prej rrëth 65 ekonomive familjare (apo rrëth 2,2% të numrit të përgjithshëm) të shpërndara si për nga veprimitaria (nën-sektoret) ashtu edhe në përfaqësimin mikro-regjional (shumica e fshatrave dhe lagjeve të qytetit të Rahovecit) përbrenda komunës. Për shkak të numrit të vogël të ndërmarrjeve të mëdha është vendosur që të anketohen direk (diku rrëth 15 biznese) e që rezultatet e këtyre janë kalkuluar në data bazën e përbashkët të të gjitha bizneseve.

Mostra finale të plotësuara përmban 104 ndërmarrje të anketuara dhe 63 ekonomi familjare. Mostra është realizuar duke u bazuar në metodën e rastit që nënkupton që mënyrën se si janë zgjedhur këto firma është e rastësishme. Shpërndarja e mostrës është bërë me metodën e rastit duke u bazuar në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe lejon mundësinë e përgjithësimit të rezultateve për Komunën e Rahovecit, duke krijuar kështu parametrat kryesor të përdorur në modelin e vlerësimit ekonomik të dëmit për tërë bizneset e sektorëve të njëjtë. Anketimi do të bëhet nëpërmjet formës elektronike online google forms, por në disa biznese si me përfaqësuese tipike të veprimitarive të caktuara, anketimi është bërë me vizite direkte nga ekipi i anketuesve e shumë shpesh nën mbikëqyrjen e projekt menaxherit. Pyetësori i dizajnuar iu është dërguar ndërmarrjeve të zgjedhura në mostër online qoftë nëpërmjet adresave të emailit apo edhe numrit të telefonit.

Për shkak të urgjencës së realizimit të studimit, projekti ka filluar së implementuar menjëherë pas nënshkrimit të kontratës. Ecuria e hulumtimit është zhvilluar në disa etapa:

1. Së pari është definuar qëllimi i hulumtimit, i cili është cekur më lartë;
2. Duke u nisur nga qëllimi është përpiluar pyetësori, në mënyrë që sa më mirë t'i përgjigjet qëllimit të anketimit; është bërë dizajnimi i pyetësorit në formë elektronike në google forms (shih linkun e pyetësorit të realizuar në këtë link (<https://forms.gle/9EqTWHSUvtMzMCBX8>)
3. Pas kësaj është bërë testimi i pyetësorit në teren, në mënyrë që të shihet ndonjë lëshim eventual i në kohën pas përfundimit të standardizimit të pyetësorit;
4. Është krijuar baza e të dhënave e cila testohet nga plotësimi i testeve provuese
5. Është bërë anketimi në teren për çdo ditë në formën online; është bërë anketimi në teren për çdo ditë; mbikëqyrja e realizimit të anketës është bërë, përmes realizimit të testeve kontrolluese, kontakti i personave te anketuar dhe kontrollit logjik të anketës;
6. Njëkohësisht gjatë zhvillimit të anketës është bërë edhe futja e të dhënave në kompjuter, në një data bazë të punuar në programin Microsoft Excel / SPSS për firmat të cilat nuk kanë mundur që të plotësojnë anketën online; pastaj ka filluar përpunimi dhe analizimin e të dhënave (prezantimet tabelore dhe statistikore);
7. Treguesit e nxjerra si mesatare të veprimitarive të ndryshme, si numri mesatar i punëtorëve, paga mesatare, fitimi mesatar, shpenzimet fikse mesatare, etj, janë përdorur si inpute bazë në modelin e vlerësimit ekonomik dhe financiar të efektit të pandemisë covid-19 në ekonominë e Rahovecit.
8. Dhe në fund është hartuar draft raporti, i cili është prezantuar si raport preliminar porositesit të hulumtimit dhe pas përmirësimeve, sugjerimeve apo komenteve është përmirësuar dhe është përgatitur raporti final.

4.3. Modeli ekonomik

Me qëllim të analizimit sa më të saktë dhe sa më gjithëpërfshirës të të gjitha veprimitarive ekzistuese të biznesit në komunën e Rahovecit, një model ekonomik është zhvilluar i dizajnuar enkas për këtë projekt. Modeli bazohet në platformën Excel dhe ka faqe të veçantë për veprimitari dhe nën veprimitari të veçanta. Veprimitaritë e ndryshme ekonomike kanë specifikat e tyre të veçanta, dhe gjithashtu janë ndikuar ndryshe nga njëra tjetra nga Covid-19. Jo të gjitha veprimitaritë ekonomike janë mbyllur njëkohësisht dhe jo të gjitha janë rihapur në të njëjtën kohë. Aktivitetet e ndryshme ekonomike si shërbimet, industria përpunuese dhe bujqësia kanë pesha të ndryshme në ekonominë e komunës së Rahovecit. Gjithashtu ato ndahen në nënkategori të cilat janë ndikuar në mënyrë të ndryshme nga pandemia. P.sh. Shërbimet ndahen në gastronomi dhe akomodim, në shërbime transporti, në tregti dhe në shërbime tjera profesionale. Asnjëra nga këto

veprimitari nuk është ndikuar njësoj prandaj meritojnë trajtim të posaçëm. Për më tepër, gastronomia p.sh. ndahet në hotele me akomodime, salsa dasmash, restorante dhe ofrues të ushqimeve dhe në kafiteri. Secila nga këto nënkategori kanë specifikat e tyre sa i përket qarkullimit, numrit të punëtorëve, shpenzimeve fikse dhe shpenzimeve të cilat ndodhin pa marrë parasysh a ishin të mbyllura apo jo e që në rastin konkret kanë ndikuar në rezultate të ndryshme sa i përket dëmit të shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Përderisa kafiteritë mund të mos paguajnë shumicën e personelit të tyre, si kamerierët p.sh. sepse mund t'i zëvendësojnë ata, restorantet në anën tjetër obligohen të paguajnë stafin e kuzhinës sepse rrezikojnë t'i humbin ata dhe pastaj nuk do të mund t'i zëvendësojnë. Njëjtë kompanitë e autobusëve dhe të transportit nuk do të mund të zëvendësonin lehtë shoferët profesionale pasi që janë të paktë. Për më shumë në sektorin e industrisë, ndërmarrjet prodhuese obligohen të mbajnë dhe paguajnë tërë stafin profesional prodhues sepse dihet se janë kuadro deficitare. Gjithashtu pagat e tyre janë shumë më të larta sesa pagat në sektorin shërbyes të gastronomisë (përjashto kuzhinierët). Bujqësia në anën tjetër ka karakteristika krejtësisht tjera dhe kryesisht është ndikuar sektori i blektorisë, dhe prodhimet e hershme ne serra (spinaqi, qepet e reja dhe produktet tjera).

Në sektorin e ndërtimit p.sh. dallojnë kompanitë që merren me ndërtim të rrugëve nga ato që ndërtojnë ndërtesa banimi. Apo veprimitaritë e elektro-instaluesve, suvatuesve, instaluesve të ujit dhe kanalizimeve, qeramikave etj, janë shumë ndryshe nga kategoritë e mësipërme. Këto të fundit në masë të madhe janë aktivitete ekonomike të firmave të vogla me 2 deri 3 të punësuar, kryesisht familjar, dhe që në masën më të madhe janë plotësisht joformale. Prandaj duhet të trajtohen veçmas në model ekonomik. Raste të tillë të veçanta kemi në secilin aktivitet prandaj kemi një numër më të madh të aktivitatave specifike të analizuara.

Në tërësi modeli ekonomik përmban 27 analiza të aktivitatave të veçanta edhe pse disa prej tyre mund të grupohen në grupacione më të mëdha siç i përmendem më lartë.

Supozimet e përdorura në modelin ekonomik

Ndër supozimet bazë dhe treguesit kryesor të përdorur në modelin ekonomik, mund të veçojmë:

- a. Humbja ekonomike është vlerësuar duke mbledhur humbjet e vlerësuara të bizneseve dhe humbjet tjera të ekonomisë që përfshijnë punëtorët e papaguar (pra që kanë mbet pa punë gjatë ndalimit të aktivitetit ekonomik si masë parandaluese e shpërndarjes së pandemisë), dhe humbjet e komunës nga taksat e reduktuara, humbjet e buxhetit të shtetit (ATK-së) dhe humbjet tjera. Prandaj humbja ekonomike është më e lartë sesa thjeshtë humbjet nga ana e bizneseve.
- b. Humbjet e bizneseve janë llogaritur duke mbledhur humbjet e shkaktuara nga shpenzimet e bëra nga bizneset në kohën kur kanë qenë të mbyllura dhe shpenzimet shtesë të shkaktuara nga Covid-19 dhe fitimi i humbur. Shpenzimet janë ndarë në fiks (pa marrë parasysh a punon a nuk punon kompania), variabile (pagat dhe shpenzimet tjera edhe pse nuk ka punuar ose punon me kapacitete të zvogëluara) dhe shpenzimet shtesë (si dezinfektimi dhe materialet mbrojtëse ndaj pandemisë). Në anën tjetër fitimi i humbur është llogaritur si përqindja e humbur e fitimit të kalkular për shkak të mos realizimit të planit pasi që bizneset janë mbyllur (mars-maj) ose punojnë me kapacitete të zvogëluara (maj-korrik).
- c. Janë përcaktuar treguesit mesatar të secilit aktivitet të analizuar, kryesisht të nxjerra nga rezultatet e anketave të kryera enkas për këtë qëllim. Këtu përfshihen pagat mesatare, numri mesatar i punëtorëve, shpenzimet mesatare shtesë (dezinfektimi etj), fitimi mesatar i paraparë (dhe përqindjet e humbura në muajt e veçantë); ndikimi mesatar i diasporës në aktivitetin ekonomik dhe në fitim, etj. Meqenëse secili aktivitet dallon nga njëri tjetri atëherë mënyra më e mirë për t'i parë këta tregues është duke shikuar modelin ekonomik në Excel, pasi që janë numër mjaftë i madh dhe nuk preferohet të paraqiten të gjithë në raport sepse mund të krijojnë konfuzion. Në raste të caktuara është bërë përshtatja duke marrë parasysh edhe nivelin e deklarimeve, ku dihet se një numër i madh i kompanive nëndeklaron për qëllime tatimore.
- d. Vlerësimi bazë i dëmit ekonomik është bërë për periudhën 13 mars deri me 30 qershor 2020. Dhe meqenëse Covid-19 do ketë pasoja më të mëdha nga mosardhja e diasporës në Kosovë këtë verë, dhe për shkak të varshmërisë së ekonomisë sonë nga shpenzimet që bëjnë diaspora gjatë verës, atëherë efektet negative ekonomike do të vazhdojnë gjatë gjithë vitit 2020. Prandaj modeli ekonomik do bëjë matjen e ndikimeve negative në ekonomi jo vetëm për periudhën deri tani por edhe parashikimet për tërë vitin 2020.
- e. Meqenëse ekonomia e Kosovës karakterizohet nga një pjesë mjaftë e konsiderueshme e ekonomisë joformale, që në tërësi vlerësohet të jetë mes 30%

deri 50% varësisht nga veprimtaritë edhe ekonomia e komunës së Rahovecit nuk përbën ndonjë përjashtim. Informaliteti paraqitet kryesisht në tri forma të cilat janë marrë parasysh në këtë analizë: 1) Ndërmarrjet që kanë aktivitet ekonomik por që nuk janë regjistruar (kafiteritë, dyqanet e vogla me veprimitari të ndryshme, firmat e vogla familjare kryesisht në ndërtimtari, ekonomitë familjare në nën sektorët e ndryshëm të bujqësisë, etj.), 2) Ndërmarrjet të cilat janë të regjistruara por që deklarojnë qarkullimin me zero, dhe 3) Ndërmarrjet që janë të regjistruara por që deklarojnë qarkullim më pak sesa realiteti, përfshirë këtu edhe numrin e punëtorëve. Sektorët e ndryshëm marrin pjesë në informalitet në forma dhe përqindje të ndryshme, prandaj ne jemi kujdesur të jemi sa më gjithëpërfshirës duke iu përshtatur sektorëve, si p.sh. në sektorin e shërbimeve, përfshirë gastronominë, informaliteti është më shumë në mos deklarimin e punëtorëve dhe qarkullimit, ndërsa në sektorin e ndërtimtarisë shumë firma të vogla operojnë pa u regjistruar ose deklarojnë me zero. Modeli ekonomik merr parasysh karakteristikat sektoriale kur merret me përfshirjen e informatitetit në analizë.

- f. Modeli ekonomik do shfrytëzohet për analizimin e skenarit bazë, dhe dy skenarëve më optimist ku do testohet me humbje më të vogla për 10% dhe 20%, dhe dy skenarëve më pesimistë me humbje më të larta prej 10% dhe 20%. Këto skenarë do aplikohen për të gjitha veprimtaritë e parapara si në tabelën përbledhëse.

Të dhënat

Për shkak të pamundësisë për të bërë një evidentim të plotë dhe një analizë të bazuar në të dhënat individuale të secilit biznes në Komunën e Rahovecit, pasi që koha e shkurtër dhe resurset e pamjaftueshme nuk e kanë mundësuar një punë të tillë, kjo analizë është më e thjeshtësuar por gjithsesi gjithëpërfshirëse, dhe bazohet në metodat e listuara më poshtë:

1. Anketat online me bizneset në komunën e Rahovecit. Duke u bazuar në listën e kompanive që operojnë në Rahovec nga regjistri i Agjencionit të Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), pastaj në listën e bizneseve qe komuna i ka taksuar si dhe në listën e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) për kompanitë e regjistruara si aktive, një sms dhe email është dërguar tek një pjese e konsiderueshme e bizneseve të listuar të Rahovecit për t'i kërkuar të plotësojnë pyetësorin online me të dhënat të cilat do shërbenin si bazë e analizave të mëtutjeshme. Meqenëse me qëllim të vlerësimit të dëmit ekonomik nevojiten të dhëna financiare rreth qarkullimit dhe fitimit të kompanive, dhe nisur nga fakti tashmë i njohur se në Kosovë ka shumë informalitet dhe evazion fiskal, atëherë shumica e kompanive kanë hezituar të plotësojnë pyetësorin e dërguar. Megjithatë

një numër prej 104 kompanive janë përgjigjur pozitivisht pyetësorit online dhe në vizitat direkte që grapi i anketuesve i ka zhvilluar në këtë projekt.

2. Me qëllim të mbledhjes së të dhënave sa më të sakta dhe sa më shumë që ishte e mundur, janë organizuar anketa me vizita të drejtpërdrejta fizike nga ana e anketuesve. Në këtë përpjekje janë mbledhur më shumë informata sesa në projektin online. Me gjithë reagimet negative nga shumë kompani të cilat nuk ishin të gatshme të hapin librat e tyre financiar për këtë projekt, megjithatë janë mbledhur të dhëna më se të mjaftueshme për të përcaktuar treguesit mesatar financiar dhe tjerë për sektorë të ndryshëm. Këto të dhëna të mbledhura janë bashkangjitur të dhënave të mbledhura online për të krijuar një mostër reprezentative nga e cila mund të nxjerrim rezultatet e synuara sa më të sakta.
3. Meqenëse veprimtaritë e ndryshme kanë edhe specifika të ndryshme dhe disa biznese janë më të mëdha dhe më të rëndësishme se tjerat, ne kemi zbatuar metodën e intervistimit të veçantë të disa prej firmave kryesore në komunë. Pesha e tyre specifike në tërësinë e ekonomisë së komunës së Rahovecit është mjaft domethënëse dhe prandaj marrja e informatave kualitative si shtesë ndaj atyre financiare ka qenë çelësi drejtë kuptimit më të mirë të ndikimit të pandemisë Covid-19 në ekonomi dhe drejtë nxjerrjes së disa përfundimeve dhe rekomandimeve më domethënëse dhe më të dobishme për komunën dhe shtetin.
4. Numri i bizneseve më të mëdha në Rahovec është i kufizuar dhe ato janë më mirë të organizuara sesa bizneset tjera. Prandaj kjo ka mundësuar që të bisedohet me to veçmas dhe të kuptohen më mirë jo vetëm humbjet financiare të tanishme, por edhe problemet kyçë nga pandemia të cilat do të ndikojnë edhe në të ardhmen e afërt të këtyre bizneseve, si dhe të kuptohet më mirë se çfarë masash duhet ndërmarrë për të tejkaluar sa më mirë dhe më shpejtë këtë situatë të pafavorshme dhe për t'u kthyer në normalitet.

5. Rezultatet e studimit

Në këtë nënkapitull janë prezantuar rezultate nga anketimi në teren si dhe rezultate nga modeli i posaçëm ekonomik.

5.1. Rezultatet e anketës me biznese

Izolimi dhe kufizimi i lëvizjes së njerëzve në shkallë të gjerë, kufizimet e udhëtimit dhe masat për distancimin shoqëror dhe masat tjera restriktive për mbylljen e bizneseve shkaktojnë një rënje të ndjeshme të shpenzimeve të konsumatorit dhe biznesit. Kjo për arsy, se konsumatorët qëndrojnë në shtëpi, bizneset humbasin të ardhurat dhe pushojnë punëtorët dhe nivelet e papunësisë rriten ndjeshëm. Për pasojë, bizneset heqin dorë nga investimet dhe falimentimet e kompanive rriten, duke bërë presion të ndjeshëm në sistemin bankar dhe financiar.

Pavarësisht numrit të vogël të rasteve në komunën e Rahovecit, masat e mbylljes së bizneseve si dhe kufizimit të lëvizjes së qytetarëve kanë qenë të njëjtë sikurse edhe në tërë Kosovën. Kjo situatë ka ndikuar që bizneset private dhe ekonomitë familjare të përvetojnë pasoja dhe dëme materiale siç janë mbyllja e biznesit apo rënia e shitjeve dhe largimi i punëtorëve nga puna. Të dhënat e anketës tregojnë që 53% e bizneseve në komunën e Rahovecit janë mbyllur gjatë kohës së pandemisë (Figura 1). Në krahasim me komuna të tjera numri i bizneseve të mbyllura gjatë pandemisë në komunën e Rahovecit është më i vogël për shkak të pjesëmarries së madhe të sektorit të bujqësisë ku nuk është ndërprerë aktiviteti gjatë pandemisë. Megjithatë, sfidë e veçantë do të mbetet plasimi i produkteve të këtij sektori.




Figure 1. Mbyllja e bizneseve si rezultat i klimës së krijuar nga Coronavirusi

Problemi i financimit të bizneseve mbetet sfida kryesore e tyre. Shumica e bizneseve që posedojnë kredi bankare raportojnë se nuk kanë mundësi të paguajnë kësttin e kredisë (rreth 84.4%) (shih Figura 2). Kjo tregon për nevojën e dizajnit të ndihmës financiare qoftë nga Qeveria e Kosovës qoftë nga Qeveria Lokale si dhe donatorët për të asistuar në rimëkëmbjen ekonomike të bizneseve.




Figure 2. Vështirësitet në pagesën e kësteve të kredisë

Pakoja fiskale e iniciuar nga qeveria dhe që ka proklamuar se bizneset do të kenë mundësi të bëjnë shtyrjen e pagesës së kësteve të kredisë për tre muaj është implementuar në masë të madhe (ka ende punëtorë që nuk e kane marre përkrahjen 170 EUR / muaj nga qeveria, e sidomos ka ngecje në pagesën e pjesës së ndihmës për qira, të cilat deri tani nuk janë shpërndarë për bizneset).

Si rezultat i rënies së kërkësës dhe problemeve të shkaktuara nga Pandemia COVID-19 një numër i madh i bizneseve kanë deklaruar se kanë anuluar investimet e planifikuara për zgjerim të biznesit (rreth 67%), gjë që paraqet problem për rimëkëmbje ekonomike të sektorit privat. Situata është e njëjtën pothuajse në të gjithë sektorët (shih Figura 3). Bujqësia është sektori më pak i goditur nga pandemia sa i përket planeve të investimeve për zgjerim. Megjithatë, problem i bujqësisë mund të jenë sfidat rreth plasmanit të produkteve në treg vendor dhe sidomos ato produkte që janë destinuar për eksport.




Figure 3. Anulimi i investimeve të planifikuar në infrastrukturë dhe/ose prodhim për shkak të shpërthimit të COVID-19?

Një ndër problemet kryesore të bizneseve sipas anketës janë zvogëlimi i kërkesave të klientëve dhe rrjedha e parasë (Figura 4).




Figure 4. Vlerësimi i ndikimit negativ ekonomik të Coronavirusit në biznes

Ndikimi i pandemisë në biznese dhe ekonomi familjare është evident, dhe si e tillë e shton nevojën e përkrahjes së sektorit privat në formë të ndryshme. Megjithatë, një numër i madh i bizneseve në komunën e Rahovecit nuk janë në dijeni rreth masave të ndryshme që ka iniciuara nga Qeveria Kosovë. Kjo shtron nevojën që këto biznese të informohen drejt lidhur me mundësitet që i kanë dhe poashtu t'i ofrohet mbështetje përmës aplikuar në masat e qeverisë dhe tek donatorët.

Një ndër çështjet e rëndësishme që duhet t'i kushtojë rëndësi Komuna e Rahovecit është informimi i qytetarëve lidhur me masat e qeverisë së Kosovës përmës përkrahjen e bizneseve në luftimin e pandemisë. Kjo përmës arsyen se rreth 31% e bizneseve në këtë komunë nuk janë në dijeni të masave të ndryshme të mbështetjes nga Qeveria e Kosovës përmës ndihmuar bizneset përmës përbashkëtësimit (figura 5).




Figure 5. Informimi i bizneseve lidhur me masat e ndryshme të mbështetjes nga Qeveria

Lidhur me nevojën për përkrahje për të përballuar pandeminë, pronarët e bizneseve të anketuara raportojnë se mjetet financiare pa kthim janë preferenca kryesore e bizneseve (rreth 80%), pastaj mbulimi i shpenzimeve operative të biznesit (10.6 %) si dhe mbulimi i shpenzimeve të interesit nga bankat (rreth 5%) (Figura 6).




Figure 6. Lloji i përkrahjes për t'i ndihmuar bizneseve për të përballuar Corona virus-in

Në pyetjen se “A parashihni ndikim ekonomik negativ të situatës së krijuar nga Corona virusi në biznesin tuaj, në 6-12 muajt e ardhshëm?” 97% e bizneseve të anketuara kanë deklaruar se parashohin ndikim negativ në 6-12 muajt e ardhshëm.

Në anën tjetër në pyetjen se “Nëse klima aktuale e biznesit si rezultat i Corona virus-it do të vazhdonte, sa kohë do të duhej që biznesi juaj të ketë ndikime të negative, siç është largimi i punonjësve nga puna?” rreth 30% e të anketuarit raportojnë se mund të përballojnë ndikimin negativ të Corona virusit 1-3 muaj, ndërsa vetëm rreth 14.4% e bizneseve mund të përballojnë ndikimin negative të pandemisë 3-6 muaj.




Figure 7. Ndikim negativ i Pandemisë Covid-19

Në aspektin e ndikimit të pandemisë në operimin e bizneseve në të ardhmen, rezultatet tregojnë se mbi 65% e bizneseve e vlerësojnë situatën e tyre në vitin e ardhshëm do të jetë “shumë e keqe” apo “e keqe” (Figura 8). Një pjesë e vogël e bizneseve janë optimist sa i përket të ardhmes dhe e shohin fazën e pas pandemisë si një mundësi për biznes. Këto rezultatet tregojnë se Komuna e Rahovecit duhet të përpilojë një plan më afatgjatë për përkrahje të bizneseve, sepse shumica prej tyre do të ballafaqohen me ndikim afatgjatë të pandemisë.




Figure 8. Optimizmi i ndërmarrësve për të ardhmen pas pandemisë

5.2. Rezultatet e modelit ekonomik

Nga analizat në skenarin bazë në modelin e ndërtuar enkas për të vlerësuar dëmin ekonomik të shkaktuar nga pandemia Covid-19 në ekonominë e komunës së Rahovecit, është vlerësuar se dëmi i përgjithshëm për periudhën 13 mars deri më 30 qershor 2020 është rreth 37 milion euro. Nga kjo shumë, rreth 33 milion euro janë humbje të vlerësuara nga bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit dhe nga ekonomitë familjare të cilat merren me kultivimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, kryesisht blegtoriale. Vlera prej 3 milion euro është dëmi i shkaktuar për shkak të pezullimit apo humbjes së vendeve të punës gjatë kësaj periudhe, e përllogaritur si vlera e pagave të papaguara. Humbjet nga taksat dhe tatimet e pa-inkasuara për shkak të ndërprerjes së aktivitetit ekonomik janë përllogaritur në vlerën prej 600 mijë euro. Kjo është shumë të cilën kompanitë do të duhej t'i paguanin shtetit sikurse të kishte vazhduar aktiviteti ekonomik i rregullt, por që nuk ka ndodhur. Ndërsa humbjet tjera të ndryshme ekonomike janë vlerësuar në shumën prej rreth 920 mijë euro. Këto rezultate janë paraqitur në tabelën 1 dhe figura 9 më poshtë.

Table 1. Vleresimi i humbjeve në Komunën e Rahovecit nga Covid-19, skenari bazë

	Humbjet në ekonomi	Humbjet për biznese	Punësimi i papaguar	Taksa dhe tatime	Humbje tjera
Skenari bazë	36,979,464	32,728,369	3,075,449	614,958	918,771

Burimi: Modeli ekonomik i vlerësimit të dëmit nga pandemia covid-19

Meqenëse sektorët e ndryshëm ekonomik janë ndikuar në mënyra të ndryshme, për shkak të karakteristikave të tyre por edhe për shkak të masave të ndryshme të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës me qëllim të parandalimit të shpërndarjes së pandemisë, atëherë edhe modeli ekonomik është ndërtuar ashtu që të na mundësojë vlerësimin më analistik sipas këtyre veprimtarive ekonomike. Kjo është shumë e rëndësishme për të kuptuar efektet reale dhe për të qenë në gjendje për t'u kundërpërgjigjur me masat adekuate për rimëkëmbjen e këtyre veprimtarive specifike dhe të ekonomisë në tërsi.

Nga analizat e bëra del se sektori i gastronomisë dhe akomodimit është sektori më i dëmtuar me humbje të tërësishme të vlerësuara mbi 7.15 milion euro për periudhën mars-qershor 2020, ku restorantet kanë peshën më të madhe të dëmit me 3.4 milion, pasuar nga kafiteritë me 2.9 milion dhe hotelet me rreth 1 milion. Bizneset në këtë sektor kanë humbur diku rreth 7 milion ndërsa punëtorët e këtyre veprimtarive janë ndër më të prekurit, kjo për shkak se lirimi nga puna në këtë sektor ndodh më lehtë sesa në veprimtaritë tjera. Ky sektor edhe ka qenë sektori i mbyllur plotësisht dhe ende nuk është hapur për të punuar me kapacitete të plota as deri në fund të muajit qershor. Ndërsa humbjet me të mëdha këtij sektori do i shkaktohen gjatë periudhës së verës korrik-shtatore, të cilat sipas disa vlerësimeve humbjet do të rriten dukshëm (sidomos nga organizimi i dasmave, Rahoveci ka mbi 20 salla ku organizohen dasma që në sezonin korrigushte kanë shfrytëzim e kapaciteteve maksimal dhe po thuaj i gjithë qarkullimi vjetor i tyre bëhet në këtë periudhe të vitit), por sidomos numri i të larguarve nga puna do jetë i konsiderueshëm në gastronomi në raport me sektorët tjerë.

Ndërtimtaria dhe tregimi i materialit ndërtimor është sektori i cili ka shënuar humbje shumë të mëdha, të vlerësuara në rreth 5.3 milion euro. Nga kjo shumë, është vlerësuar se bizneset në këtë veprimtari kanë humbur 4.7 milion.

Sektori i industrisë përpunuese, siç edhe pritej, vlerësohet si një sektor me dëm të lartë nga pandemia. Kjo për arsy se në komunën e Rahovecit ka një numër mjaftë të madh të prodhuesve dhe përpunuesve të cilët kanë arritur të eksportojnë jashtë Kosovës, përfshirë këtu industrinë e miellit, industrinë e prodhimit të frigoriferëve, prodhimin e elementeve të plastikës, (dyer, dritare, elemente të kuzhinës, pajisjeve të ndryshme të industrisë e amvisërisë etj), prodhimin e verës dhe destilerve të ndryshëm, industrisë së përpunimit të telit, rrjetave, metaleve, gypave të ndryshme, zdrukthëtarëve dhe përpunuesve tjerë të drurit. Megjithëse ky sektor nuk është ndaluar me masa administrative të drejtëpërdrejta, megjithatë me vendosjen e ndalim qarkullimit është prekur thellësisht dhe kjo ka rezultuar me humbje të mëdha rrethe 7.8 milion. Gjithashtu mbyllja e kufijve shtetëror jo vetëm në Kosovë por edhe në vendet e destinacionit eksportues, ka ndikuar në ndërprerjen e eksporteve dhe kjo mund të konsiderohet si humbja më e madhe jo vetëm materiale por edhe ekonomike në aspektin cilësor. Prandaj modeli vlerëson se humbja ekonomike në

sektorin e industrisë përpunuese në komunën e Rahovecit është mjaftë i madhe për periudhën mars-qershor 2020. Siç u përmend, dhe kjo ka dalë në secilën bisedë me prodhuesit që eksportojnë, problem kryesor nuk është vetëm humbja afatshkurtër ekonomike por humbja e mundshme e tregut të jashtëm i cili mezi që është krijuar ndër vite.

Tregtia e tekstit, ku përfshihet tregtia me shumicë dhe pakicë, është sektori tjetër që për shkak të karakteristikave të saj ka pasur humbje shumë të mëdha, përfshirë humbjen në substancë. Kjo për arsy se një pjesë e mallit tek tregtarët me shumicë, dhe pothuajse i tërë malli tek tregtarët me pakicë është zhvlerësuar dukshëm. Ky zhvlerësim ndodh për shkak se si sektor ishte i mbyllur për një kohë të gjatë dhe pas hapjes malli në dispozicion është mall jashtë sezone, dhe si i tillë nuk shitet. Gjithashtu pasi që kufijtë kanë qenë të mbyllur atëherë edhe mundësia për të furnizuar butikët ka qenë pothuajse i pamundur. Malli ekzistues do të mund të shitet vetëm në sezonin e ri vitin tjetër dhe meqenëse moda ndryshon tepër shpejtë, të gjitha këto rroba do janë jashtë trendëve të modës dhe si i tillë me një vlerë të degraduar dukshëm. Modeli sugeron se sektori i tekstit ka pasur humbje prej 2.75 milion, humbje e cila do të mund të rritet me zhvlerësimin e mëtutjeshëm të mallit. Problemi tjetër i këtij sektori është se me mallin e bllokuar ky sektor është tepër i etshëm për likuiditet pasi që nuk ka para të mjaftueshme në dispozicion për të ri furnizuar dyqanet. Kjo e bënë humbjen në këtë sektor edhe më të dhimbshme dhe një numër i madh i bizneseve rrezikon seriozisht që të mbyllë aktivitetin ekonomik.

Sektori i transportit të pasagjerëve, edhe pse një sektor relativisht i vogël me pak kompani me të mëdha të autobusëve dhe numër të limituar të kompanive më të vogla, megjithatë është ndër sektorët më të prekur nga Covid-19. Kjo për arsy se është ndër sektorët e parë të mbyllur plotësisht dhe të cilin ende nuk e kanë kthyer plotësisht. Me gjithë hapjen e përsëritshme të aktivitetit me datën 18 maj, me kushte strikte të mbajtjes së distancës së pasagjerëve dhe kufizimit të numrit të tyre, kjo nuk u mundëson kompanive që të veprojnë me një profitabilitet, dhe shpesh nuk janë në gjendje të mbulojnë shpenzimet e tyre, kështu që si sektor është ende thaujse i mbyllur. Humbjet në transportin e pasagjerëve, ku përfshihen kompanitë e autobusëve, minibusëve dhe takseve, janë vlerësuar në 0.7 milion, që janë shumë të larta pa marrë parasysh madhësinë e sektorit. Një karakteristikë tjetër është se ky sektor konsideron se ka humbje në substancë pasi që vlera e aseteve të tyre (autobusëve) ka rënë dukshëm për shkak të mos-aktivitetit.

Shërbimet tjera, ku hyjnë agjencionet e ndryshme shërbyese për ekonomi, jurispodencë (shërbimet e kontabilitetit, avokaturës), shërbime riparimi, tregti e auto veturave dhe pjesëve të automjeteve, auto serviset, shitoret e specializuara, shërbimet mjekësore,

sporti dhe kultura, pastaj floktarët dhe frizerët etj, vlerësohet të kenë humbur 7.3 milion euro për periudhën mars-qershor 2020. Humbjet e bizneseve në këto veprimtari konsiderohen të janë rreth 6 milion. Veprimtaritë tjera, ku hyjnë marketet dhe shumë veprimtari tjera ekonomike të pa përfshira në grupet e lartcekura, është vlerësuar të kenë humbje prej 3.2 milion për periudhën mars-qershor 2020, prej të cilave 2.8 milion humbje të bizneseve.

Meqenëse bujqësia dhe blegtoria janë sektor shumë të rëndësishëm për ekonominë e komunës së Rahovecit, një vlerësim i veçantë është bërë për sektorin e bujqësisë, kryesisht ekonomive familjare. Sipas modelit vlerësohet se sektori i bujqësisë dhe ekonomive familjare ka pësuar një humbje prej rreth 3.1 milion euro për periudhën mars-qershor 2020. Kjo për arsy se për shkak të ndalim qarkullimit dhe ndërprerjes së tregut ku fermerët do mund të tregtonin produktet e tyre, përfshirë qumështin dhe produktet e qumështit, vjetat (viq), qengjat dhe kecat, pastaj pulat dhe vezët dhe produkte tjera kryesisht blegtoriale, një pjesë e tyre nuk ka arritur të shitet dhe një pjesë e fitimit nga këto veprimtari ka humbur. Tashmë realisht për fat të mirë nuk kemi humbje të stokut të bagëtisë dhe se vonimi në shitjen e qengjave apo vjetave do të nënkuftojë se ata janë rritur dhe në të ardhmen do të mund të shiten me çmim më të lartë por mbajtja e tyre ka kërkuar kosto shtesë dhe ka shkaktuar humbje të afatshkurtër të paparashikuara. Gjithashtu edhe pse një pjesë e produkteve bujqësore shitet nëpër familje pa dalë në treg, megjithatë ndalim qarkullimi e ka vështirësuar edhe këtë pjesë të ekonomisë duke krijuar humbje shtesë.

Rezultatet e analizave sipas veprimtarive të veçanta janë paraqitur në tabelën 2 më poshtë.

Table 2. Vlerësimi i humbjeve në komunën e Rahovecit nga Covid-19, sipas veprimtarive kryesore, skenari bazë

Sektorët	Humbjet në ekonomi	Humbjet për biznese	Humbja zhvlersi. mallit	Punësimi i papaguar	Taksatime	Humbje tjera
Gastronomia dhe akomodimi	7,155,735	5,805,585	-	914,595	128,273	307,283
Ndërtimtaria dhe malli ndërtimor	5,314,869	4,709,186	360,000	366,952	233,481	190,290
Transporti i pasajereve	516,210	474,255	189,000	21,840	9,059	15,377
Tregtia e tekstitit	2,516,400	2,178,420	1,043,500	263,172	28,824	45,984
Industria	7,800,776	7,519,727	-	184,680	22,239	74,130
Shërbimet tjera	7,325,135	6,082,213	984,000	904,210	187,791	265,128
Blegtoria dhe ekonomitë familjare	3,133,783	3,133,783	-	-	-	-
Veprimtaritë tjera	3,216,556	2,825,200	-	420,000	5,292	20,580
Total	36,979,464	32,728,369	2,576,500	3,075,449	614,958	918,771

Burimi: Modeli ekonomik i vlerësimit të dëmit nga pandemia Covid-19

Rezultatet e prezantuara këtu nuk përfshijnë humbjet afat-mesme dhe afat-gjata ekonomike për shkak të stagnimit apo shtyerjes së investimeve produktive për një kohë tjetër, për shkak se kompanitë janë detyruar të përdorin fondet e parapara për investime si likuiditet shtesë për të mbijetuar në kushtet e pandemisë. Shtyrja e këtyre investimeve për një afat shpesh të pacaktuar e shtyn lakoren e fitimit potencial duke e ndryshuar trendin e deritanishëm dhe kjo krijon humbje afat-gjatë. Ato humbje nuk janë kalkuluar dhe nuk janë përfshirë në këtë vlerësim të ndikimit të pandemisë Covid-19 në ekonominë e komunës së Rahovecit.

Meqenëse pandemia nuk ka kaluar dhe se efektet e saj parashihet nga shumica e bizneseve të ndjehen deri në 2 vitet e ardhshme, ne kemi tentuar të parashikojmë se sa dojenë humbjet ekonomike të krijuara nga pandemia në vitin 2020. Nën supozimin kryesor se qeveria nuk do të rivendos masat e ndalim qarkullimit, apo mbylljen e përkohshme të bizneseve sikurse në muajt e kaluar; dhe se diaspora e Kosovës nuk do të vijë në vizitë me shifra të larta sikurse në të kaluarën, prandaj sasia e parasë në qarkullim do jetë e kufizuar, një vlerësim i humbjes potenciale ekonomike në vitin 2020 në komunën e Rahovecit rezulton prej gati 40 milion euro. Ky është vlerësim mjaft konzervativ i cili bazohet në supozimet se ekonomia gradualisht do t'i i kthehet normalitetit, dhe se qeveria do të rrisë likuiditetin në ekonomi duke futur shuma të mëdha të stimujve financiar. Në të kundërtën

në rast të stimujve të pamjaftueshëm dhe rënies së likuiditetit financiar në ekonomi humbjet do ishin shumë më të larta sesa që sugjeron modeli.

Përpos skenarit bazë analizat e stres testeve ku janë testuar skenarët me 10% dhe 20% humbje më të larta, apo 10% dhe 20% humbje më të ulëta, gjithashtu tregojnë se humbjet në ekonomi janë shumë të larta në cilindro skenar. Rezultatet e stres testeve janë paraqitur në tabelën 3 më poshtë.

Table 3. Vleresimi i humbjeve në Komunën e Rahovecit nga Covid-19, skenaret e ndryshem, stres teste

Skenarët	Humbjet në ekonomi	Humbjet për biznese	Humbja zhvlerësimi i mallit	Punësimi i papaguar	Taksa dhe tatime	Humbje tjera
Skenari baze	36,979,464	32,728,369	2,576,500	3,075,449	614,958	918,771
Skenari 1: 10% humbje më të vogla	35,981,518	26,635,127	2,318,850	2,767,904	553,462	826,894
Skenari 2: 20% humbje më të vogla	31,983,571	23,675,669	2,061,200	2,460,359	491,967	735,017
Skenari 3: 10% humbje më të larta	43,977,411	32,554,045	2,834,150	3,382,994	676,454	1,010,648
Skenari 4: 20% humbje më të larta	47,975,357	35,513,503	3,091,800	3,690,539	737,950	1,102,525

Burimi: Modeli ekonomik i vlerësimit të dëmit nga pandemia covid-19

Gjate zhvillimit të këtij projekti kemi zhvilluar edhe skenarët e tjera duke marre parasysh vazhdimin e pandemisë deri në fund të vitit me këto masa kufizuese që janë aktualisht duke u aplikuar si dhe duke e marre parasysh një faktor shumë me rendesi mos ardhja e mërgatës në pushimet verore gjatë muajve korrik-gusht 2020.

Sipas skenarëve të lartekura humbjet priten të janë edhe me të mëdha në sektorin e ekonomisë së komunës së Rahovecit, sidomos të gastronomisë. Me poshtë është prezantuar tabela 4 me rezultatet e humbjeve te supozuara sipas modelit ekonomike deri më 31 gusht (mungesa e ardhjes së mërgatës gjatë pushimeve verore e kombinuar me masat kufizuese të qeveris për zhvillimin normal të biznesit) dhe deri me 31 dhjetor 2020 si pasoj e vazhdimit të pandemisë dhe masave kufizuese për bizneset e komunës së Rahovecit:

Table 4. Vleresimi i humbjeve në Komunën e Rahovecit nga Covid-19, skenarët e ndryshëm, nëse situata do vazdoj me këto tende (mungesa e mërgatës ne KS – 31 gushte, dhe vazhdimi i pandemisë dhe masave kufizuese deri me 31 dhjetor '20)

Veprimtaria	Humbjet ne ekonomi mars - 30 qershor	Humbjet ne ekonomi -31 gusht	Humbjet ne ekonomi -31 dhjetor
Totali ne EUR	36,979,464	48,152,202	57,965,345

Burimi: Modeli ekonomik i vlerësimit të dëmit nga pandemia covid-19

Sipas analizës së bërë në modelin makroekonomike ka dal që nëse mërgata e jonë nuk do vije për pushime dhe supozohet që masat kufizuese do jenë aktive deri me 31 gusht 2020-humbjet në ekonomi do të rriteshin edhe për rreth 11 milion ose do silleshin në total në rreth 48 milion për bizneset e komunës së Rahovecit. Nëse masat kufizuese për zhvillimin e biznesit normal të Qeverisë së Kosovës do vazhdojnë deri në fund të këtij viti 31 dhjetor, - humbjet në ekonomi do arrijnë deri në rrethe 58 milion për ekonominë e Rahovecit.

Situatë të pafavorshme ekonomike mund ta përkunjësoj edhe më shumë nëse sektori i perimekulturës nuk do arrij të plasoj në treg, produktet e veta sipas planeve, kontratave dhe dinamikave normale të tregut aktual, i cili është duke funksionuar edhe pse me kufizime të pjesshme. Këtu duhet cekur edhe problemet e mundshme të shitjes së prodhimeve të llojeve të ndryshme të rrushit dhe produkteve të tij (verës dhe destilateve tjera alkoolike) të cilat do ta thelloni edhe më shumë humbjen ekonomike në komunën e Rahovecit.

6. Përfundime dhe rekomandime

Bazuar në rezultatet e anketës së realizuar për vlerësim të ndikimit të pandemisë Covid-19 në ekonominë e komunës së Rahovecit dhe në rezultatet e modelit ekonomik dhe financiar të dizajnuar enkas për këtë vlerësim, he mund të përfundojmë se ekonomia e komunës ka pësuar dëme të theksuara gjatë periudhës së mbylljes dhe se për shkak të ndikimit të pandemisë në kufizimin e lëvizjes së diasporës, ato dëme pritet të janë dukshëm më të larta.

Në përfundimet kryesore mund të listohen si vijon:

1. Humbjet ekonomike ndahen në humbjet për biznese, humbjet nga punëtorët (për shkak të pezullimit të punës apo humbjes së vendit të punës) dhe humbjet tjera ku hyjnë edhe humbjet nga mosrealizimi i tatimeve.
2. Shtyrja apo pezullimi i investimeve të planikuara nga bizneset do ketë pasoja negative dhe ndikon drejtpërsëdrejtë në zvogëlimin e fitimit në të ardhmen. Prandaj dëmi ekonomik shkon përtëj dëmit të shkaktuar në afatin e vlerësuar mars-maj 2020.
3. Dëmet e bizneseve në afatin mars-qershor 2020 janë shkaktuar nga shpenzimet fikse apo të domosdoshme për mbajtjen e biznesit aktiv, pa marrë parasysh se a ka pasur aktivitet dhe realizim të të hyrave dhe nga fitimi i humbur për shkak të mos-aktivitetit. Shumë biznese janë detyruar të paguajnë punëtorët pa marrë parasysh

a kanë punuar apo jo me qëllim të mbajtjes së tyre pasi që janë kuadro deficitare (kuzhinierët, shoferët e autobusëve, punëtorët në prodhimtari, etj).

4. Disa veprimitari ekonomike përpos humbjes së fitimit kanë pësuar edhe humbje në substancë si psh. zhvlerësimi i aseteve (autobusëve) te ndërmarrjet e transportit të pasagjerëve, zhvlerësimi i mallit për shkak të kalimit të sezonës (tek rasti i tregtisë së tekstilit, kryesishët veshmbathjes), prishja e produkteve te sektori i bujqësisë.
5. Ndër humbjet potenciale më të mëdha të theksuara nga prodhuesit dhe eksportuesit, e që nuk mund të vlerësohet lehtë është humbja potenciale e tregut të eksporteve të krijuar me shumë mund dhe përkushtim shumëvjeçar. Për shkak të mbylljes së kufijve jo vetëm nga Kosova por edhe nga vendet tjera, dhe për shkak të ndërprerjes së prodhimtarisë, shumë eksportues nuk kanë arritur të përmbushin kontratat e tyre dhe kështu rrezikojnë seriozisht humbjen e tregut të eksportit. Kjo mund të rezultojë me humbje shumë të mëdha ekonomike dhe financiare për këtë sektor.
6. Mungesa e likuiditetit nga bizneset në Rahovec paraqitet si njëra ndër problemet kryesore të shkaktuara nga situata me pandeminë covid-19. Bizneset paksa më të mëdha kanë përdorur rezervat e tyre të parapara për investime për të përmbushur deri diku nevojat për likuiditet, ndërsa bizneset më të vogla janë në një situatë plotësisht të pafavorshme dhe në mungesë të theksuar likuiditeti. Tregtarët e veshmbathjeve p.sh. kanë pothuajse tërë kapitalin e tyre të blokuar në mall i cili nuk shitet për shkak të kalimit të sezonës dhe nuk kanë mjete likuide për të zëvendësuar stoqet kurdo të krijohet mundësia për qarkullim ndërkombëtar.
7. Ndikimi i diasporës në ekonominë e komunës së Rahovecit është vendimtar për mbijetesë ekonomike, prandaj meqenëse pritet se shumica nuk do mund të vijnë këtë verë edhe humbjet ekonomike dhe financiare për ekonominë e Rahovecit pritet të jenë dukshëm më të larta sesa ato deri tani. Mungesa e ardhjes së diasporës nënkuption sasi më të vogël të parasë në qarkullim dhe kërkësë dukshëm më të vogël për mallrat dhe shërbimet e ofruara. Kjo do rezultojë me stagnim të madh të aktivitetit ekonomik dhe humbje të mëdha sidomos për këtë vit kalendarike.

Ndër rekomandimet kryesore që dalin nga rezultatet e këtij studimi mund të theksohen:

1. Si masë urgjente nga Qeveria e Kosovës të konsideron rishikimin e ligjit për buxhetin e shtetit 2020, aprovimin e pakos për rimëkëmbjen ekonomike 2020/2021, si dhe integrimin në ligjin e të mbështetjes financiare për të shmangur falimentimin e bizneseve dhe rënien ekonomike.

2. Qeveria e Kosovës të konsiderojnë se nevojitet një instrument i ri financiar në lidhje me financimin afatgjatë të politikave të zbatuara për të eliminuar pasojat ekonomike
3. Qeveria të angazhohet për rritja e likuiditetit përmes infuzionit financiar nga shteti duke shfrytëzuar instrumentet si:
 - a. Kompensimin e dëmit përmes instrumenteve të ndryshme ligjore e financiare (siç edhe parashihet me ligjin mbi fatkeqësitet natyrore dhe fatkeqësitet tjetra nen 30);
 - b. Ofrimi i instrumenteve të kreditimit afat-gjatë me një grace periudhë një vjeçare dhe norma të përballueshme të kamatave;
 - c. Ndihma përmes garantëve dhe subvacioneve të drejtpërdrejta për veprimtaritë që kanë nevojë më shumë për likuiditet.
4. Mbështetja e shtetit për sektorin e eksporteve me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të nevojshme të promovimit dhe ruajtjes së lidhjeve të krijuara afariste me tregun e jashtëm. Këto do përfshiheshin:
 - a. Mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit të afaristëve nga Rahoveci në vendet e destinacionit të eksporteve të tyre me qëllim të ruajtjes së kontakteve me blerësit e jashtëm;
 - b. Ndihma me grante për digitalizim të veprimtarive dhe përmirësim të produktivitetit të tyre me qëllim të ngritjes së aftësisë konkurruese;
 - c. Krijimin e skemave tjera lehtësuese që stimulojnë eksportin e prodhimeve të vendit.
5. Mbulimi nga shteti i shpenzimeve shtesë të krijuara nga pandemia, siç është dezinfekti i vazhdueshëm i ambienteve dhe aseteve të punës, ofrimi falas i maskave dhe dezinfektantëve. Kjo do krijonte dy efekte pozitive: e para, mbajtja nën kontroll të pandemisë, dhe e dyta lehtësimi i barrës financiare tashmë të rënduar të bizneseve dhe mbajtja e tyre në gjendje aktive.
6. Komuna e Rahovecit të shoh mundësinë që të bëjë lirime sa i përket taksave komunale dhe lirimin nga pagesa e qeras për bizneset e sektorëve të prekura nga kjo pandemi.
7. Komuna e Rahovecit të merr përsipër që të avokoj të QRK dhe donatoret e ndryshëm për mbështetje financiare dhe ndihma të tjera ekonomike e profesionale në mënyrë që të zbuten humbjet financiare dhe humbjet tjera afariste.
8. Sigurimi i granteve (mjete financiare pakthim) për ndërmarrjet e vogla dhe shumë të vogla (shumat do të shkojnë ndërmjet 2,000 EUR dhe 10,000 EUR)

VLERËSIMI EKONOMIK I NDIKIMIT TË PANDEMISË COVID-19 NË EKONOMINË E KOMUNËS SË RAHOVECIT

9. Krijimi i një fondi kundër krizës/krijimi i programeve të reja të mbështetjes së bizneseve fillestare dhe atyre inovative. Themeli i një linje të veçantë për bizneset inovative të cilat prodhojnë produkte dhe shërbime që kanë të bëjnë me idetë kreative për të përballuar krizën nga pandemia.
10. Asistenca teknike-kjo ndihmë përfshinë ofrimin e asistencës teknike dhe konsulencës menaxheriale në formë të konsulencës për bizneset private në Kosovë. Kjo ndihmë do duhet të përfshijë një spektër të gjerë të masave si për shembull trajnimet për shitje online, transformimi digital i bizneseve, menaxhimi i eksporteve dhe hyrja ne tregje të reja etj.

